

*D. Gaem as wo
to them o hat e to
to e of p o z t e b o r y
e to the b e a r s 25.10.2017*

23-10-17

KUVENDI
NR 2518/6 DATE 23.10.17



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

Dokument parlamentar

RAPORT REKOMANDUES

I deputetëve të mazhorancës, anëtarë të Këshillit

Për shqyrtimin e kërkesës

së Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për dhënie autorizimi për arrestim ose heqje lirie, kontroll personal dhe të banesës për deputetin e Kuvendit të Shqipërisë, z. Saimir Tahiri përcjellë në Kuvend me shkresën nr. 9906 prot., datë 19.10.2017

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, në cilësinë e organit përgjegjës parlamentar, në përputhje me nenin 13, pika 3 dhe nenin 118 të Rregullores së Kuvendit në mbledhjet e datës 20.10.2017 dhe 21.10.2017 zhvilloi procedurën e shqyrtimit të kërkesës së organit të akuzës për dhënie autorizimi për arrestim ose heqje lirie, kontroll personal ose banese për deputetin e Kuvendit të Shqipërisë, z. Saimir Tahiri.

Depozitimi i kësaj kërkesë në Kuvendin e Shqipërisë është bërë me shkresën përcjellëse nr.9906 prot., datë 19.10.2017, shoqëruar me relacionin ku parashtrihen argumentat dhe provat e organit të prokurorisë. Kjo shkresë është pranuar në Kuvend me nr. 2518 prot, datë 19.10.2017.

Shqyrtimi i kërkesës u krye nga ana e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, i cili zhvilloi procedurën e shqyrtimit bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore në fuqi.

BAZA LIGJORE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS

Shqyrtimi i kërkesës për dhënie autorizimi për arrestimin, heqjen e lirisë, kontrollin personal dhe kontrollin e banesës së deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë gjen rregullim në dispozitat e mëposhtme të Kushtetutës, Kodit të Procedurës Penale dhe Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë:

- dispozitat përkatëse të Kushtetutës, neni 73, pika 2 dhe pika 4, neni 135 dhe neni 148;
- dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, neni 288;
- Rregullorja e Kuvendit, neni 13, neni 118.

Neni 73, pika 2 dhe 4 i Kushtetutës: *“2. Deputeti nuk mund të arrestohet ose t’i hiqet liria në çfarëdo lloj forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit.*

4. Për çështjet e parashikuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, Kuvendi mund të diskutojë në seancë me dyer të mbyllura, për arsye të mbrojtjes së të dhënave. Vendimi merret me votim të hapur.”

Neni 135, pika 2 i Kushtetutës: *“Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.”*

Neni 148 i Kushtetutës: *“Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.*

2. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit.

3. Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.

4. Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme.”

Neni 288, pika 1 dhe 2 i Kodit të Procedurës Penale:

“1. Kur ndaj një deputeti duhet të caktohet masa e sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, heqja e lirisë në çfarëdo lloj forme, kontrolli personal ose i banesës, prokurori kërkon autorizim nga Kuvendi.

2. Kërkesa për autorizim paraqitet kur plotësohen kushtet ligjore të parashikuara në këtë Kod për kryerjen e veprimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Ajo shoqërohet me një relacion të arsyetuar, të shoqëruar me provat që mbështesin kërkesën e tij.”

Neni 285, pika 4 “Dispozitat kalimtare” të Ligjit 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar:

“4. Deri në krijimin e Prokurorisë së Posaçme, çështjet në hetim për veprat penale apo subjektet e parashikuara në nenin 75/a, të Kodit të ndryshuar me këtë ligj, do të hetohen përkatësisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, sipas kompetencës të përcaktuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Neni 13/3 dhe 118 i Rregullores së Kuvendit:

Neni 13/3: “Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin – 3. Me kërkesë të Kryetarit të Kuvendit, Këshilli shqyrton kërkesën për dhënien e autorizimit nga Kuvendi për fillimin e ndjekjes penale ose arrestimin e një deputeti, në përputhje me nenin 118 dhe nëse ka vend për procedim ndaj deputetit të ndaluar ose të arrestuar, sipas nenit 119 të kësaj Rregulloreje.”

4. Këshilli shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me mandatin e deputetit dhe paraqet raportin përkatës në seancë plenare.

6. Këshilli mbledhet në mënyrën e parashikuar nga kjo Rregullore për komisionet e përhershme.”

Neni 118: “Heqja e imunitetit të deputetit – “ 1. Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese për dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj deputetit i paraqiten Kryetarit të Kuvendit nga Prokurori i Përgjithshëm. Kryetari ia dërgon kërkesën dhe dokumentet shoqëruese menjëherë për shqyrtim Këshillit për Rregulloren, Imunitetin dhe Mandatet dhe vë në dijeni deputetin.

2. Deputeti, për të cilin kërkohet dhënia e autorizimit, lajmërohet për kërkesën e bërë dhe dokumentet që e shoqërojnë atë, si dhe i bëhet e ditur koha në të cilën Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin do të fillojë shqyrtimin e kërkesës. Deputeti ka të drejtë të paraqesë në Këshill, me shkrim ose me gojë, shpjegimet dhe vërejtjet e tij rreth çështjes.

3. Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli, brenda 4 javëve, harton një raport për në seancë plenare, në të cilin rekomandon rrëzimin ose miratimin e dhënies së autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj deputetit. Raporti i Këshillit u shpërndahet deputetëve.

4. Shqyrtimi i kërkesës për dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ose arrestimin e një deputeti vendoset si pikë e parë e rendit të ditës të seancës pasardhëse, pas paraqitjes së raportit të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Në seancë plenare fjala i jepet në fillim deputetit, ndaj të cilit është paraqitur kërkesa, për të dhënë shpjegime ose për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve. Raporti i Këshillit nuk është objekt diskutimi. Kuvendi vendos me votim të fshehtë nëse do të jepet ose do të rrëzohet dhënia e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj deputetit.

5. Procedura e parashikuar në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni zbatohet edhe në rastin kur kërkohet autorizimi për arrestimin e një deputeti.

6. Në rastin kur Kuvendi nuk merr vendim për dhënien ose mosdhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ose të arrestimit të një deputeti brenda 3 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës përkatëse, atëherë kërkesa konsiderohet e rrëzuar nga Kuvendi.”

I. ASPEKTE PROCEDURIALE

Nga shqyrtimi i çështjes prej Këshillit të Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit, në përputhje me dispozitat e Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, rezultoi se me shkresën nr.9906, datë 19.10.2017, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka depozituar në Kuvend, kërkesën me objekt: *“Kërkohet dhënia e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë, si dhe për të ushtruar kontroll personal dhe të banesës së deputetit të Kuvendit të Shqipërisë z. Saimir Tahiri”*.

Me depozitimin e kësaj kërkesë, në përputhje me dispozitën e nenit 13, pika 3 dhe nenit 118, pika 1 dhe 5 të Rregullores, Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë e ka dërguar menjëherë kërkesën dhe relacionin shoqërues të saj pranë Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin për të vijuar praktikën parlamentare.

Në vijim të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat përkatëse të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, menjëherë kërkesa dhe relacioni i paraqitur nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë me shkresën datë 19.10.2017, i është njoftuar deputetit z. Saimir Tahiri në adresën e tij.

Në këtë shkresë përveç dërgimit të akteve të mësipërme, deputetit z. Saimir Tahiri i është komunikuar rendi i ditës i mbledhjes së Këshillit për Mandatet, Rregulloren dhe Imunitetin, duke e vënë në dijeni për dispozitat përkatëse të rregullores që normojnë këtë procedurë, orën dhe vendin e zhvillimit të kësaj mbledhje.

Në datë 19.10.2017, ora 11.00-18.00, datë 21.10.2017, ora 10.00 – 17.00 në selinë e Kryesisë së Kuvendit të Shqipërisë, në prani të prokurorëve të çështjes, deputetit Z.Saimir Tahiri dhe avokatit të tij, me dyer të hapura, Këshilli për Rregulloren Mandatet dhe Imunitetin, i kryesuar nga Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë dhe në prani të gjithë anëtarëve (dhjetë anëtarë) të këtij Këshilli, mori në shqyrtim kërkesën e organit procedues.

II. RRETHANAT DHE ARGUMENTAT E PARASHTRUARA NGA PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË PËR KRIME TË RËNDA TIRANË

Në kërkesën dhe relacionin e përcjellë pranë Kuvendit të Shqipërisë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka parashtruar rrethanat e faktit si vijon:

2.1. Më datën 17.10.2017 në bazë të të dhënave të bëra publike pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë konform nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, ka rregjistruar procedimin penal nr 313 të vitit 2017 për veprat penale të “*Trafikimi i narkotikëve*” kryer në bashkëpunim, në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 333/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, “Korrupsionit pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë” parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal, në ngarkim të personit në hetim z. Saimir Tahiri, i biri i Bashkimit, i datlindjes 30.10.1979, banues në Tiranë dhe për veprën penale të “*Trafikimi i narkotikëve*” kryer në bashkëpunim, në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 333/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, “Korrupsioni aktiv i zyrtarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë” parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal, për personat nën hetimin Moisi Habilaj, Florian Habilaj, Artan Habilaj etj.

2.2. Prokuroria pranë Gjykatës së shkallës së parë për Krime të Rënda Tiranë, në lidhje me subjektet Moisi Habilaj, Florian habilaj, Artan Habilaj, Armand Kocerri etj ka rregjistruar procedimi penal me nr 134 të vitit 2016 dhe 164 të vitit 2017 për veprat penale të “*Trafikimi i narkotikëve*” kryer në bashkëpunim, në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 333/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Konform nenin 79 të Kodit të Procedurës Penale më datë 18.10.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka vendosur bashkimin e procedimeve penale me nr 134 të vitit 2016, 164 të vitit 2017 dhe 313 të vitit 2017 në një procedim të vetëm dhe kontretisht procedimin penal nr 134 të vitit 2016 .

2.3. Për shkak të bashkimit të procedimeve rezulton se prokuroria ka shënuar emrin në hetim të z. Saimir Tahiri, deputet në Kuvendin e Shqipërisë, si person i dyshuar për kryerjen e veprave penale të: 1. “Trafikimi i narkotikëve” kryer në bashkëpunim, në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 283/a2 dhe 333/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. 2. “Korrupsion pasiv i funksionalëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurit vendorë” parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal .

Bazuar në nenin 285 të Ligji 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, kompetente në ushtrimin e ndjekjes penale është Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.

2.4. Nga veprimet e deritanishme hetimore të kryera për efekt të këtij procedimi sipas organit procedues ka rezultuar se:

2.4.1. Nga ana e autoriteve italiane të drejtësisë është arrestuar personi nën hetim Moisi Habilaj etj, të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Trafikimi i narkotikëve, kryer në bashkëpunim, në formë të posaçme në rang të grupit të strukturuar kriminal”. Arrestimi i këtij shtetasi është bërë në funksion të hetimeve që autoritetet italiane të drejtësisë po zhvillojnë në lidhje me kapjen e një sasive prej 3.5 tonësh lëndë narkotike e llojit Cannabis Sativa.

Nga hetimet e zhvilluara nga autoritetet italiane është arritur të zbulohet se personi në hetim Moisi Habilaj dhe bashkëpunëtorët e tij kanë bashkëpunuar me zyrtarë të lartë të policisë së shtetit ku si person i dyshuar është dhe ish Ministri i Brendshëm, personi në hetim Saimir Tahiri.

2.4.2. Personi në hetim Moisi Habilaj në bashkëpunim me persona të tjerë duke përfituar nga lidhjet e ngushta me ish Ministrin e Brendshëm dhe kundrejt shpërblimeve kanë arritur të bëjnë të mundur kultivimin e sasive të konsiderueshme të lëndës narkotike, transportimin e tyre në mënyrë të organizuar me destinacion jashtë vendit. Në dijeni të këtyre detajeve dhe me veprime aktive dyshohet të ketë vepruar dhe ish Ministri i Brendshëm Saimir Tahiri, i cili ka siguruar paprekshmërinë e veprimtarisë kriminale të grupit të strukturuar kriminal dhe sigurinë e kultivimit dhe të kalimit të sasive të konsiderueshme të lëndëve narkotike.

E gjithë veprimtaria kriminale mbështetet në bashkëpunimin e grupit kriminal me strukturat e policisë së shtetit, ku përfitimet direkte monetare shkonin tek ish Ministri i Brendshëm Saimir Tahiri.

2.5. Veprimet hetimore të kryera nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, të parashtruara në kërkesë dhe relacion, përcjellë Kuvendit janë:

- Kapja dhe sekuestrimi i një sasive të konsiderueshme lënde narkotike, në masën 3.5 ton Cannabis Sativa nga autoritetet italiane të drejtësisë të dyshuara si të trafikuar nga grupi kriminal Moisi Habilaj etj.
- Më datë 18.10.2017 është kapur dhe sekuestruar një sasi lënde narkotike prej 3.978 ton e llojit Cannabis Sativa në banesën e shtetasit në hetim Armand Koçerri, bashkëpunëtor i shtetasve Moisi Habilaj, Florian Habilaj etj.
- Përgjime të komunikimeve telefonike dhe biseda ambientale, të cilat tregojnë përfshirjen në veprimtari kriminale të shtetasit në hetim Saimir Tahiri. Në këto komunikime, rezultojnë të pasqyrojnë detaje të cilat tregojnë shpërblimet që i japin ish Ministrin të Brendshëm Saimir Tahiri në funksion të realizimit të veprimtarisë së tyre .
- Subjekti nën hetimi Saimir Tahiri dhe pse në datë 05.11.2013 ka realizuar shitjen e automjetit me targë AA003GB, tek personi nën hetim Artan Habilaj, në datat 16.08.2014, 29.08.2014, 08.08.2014, është ripërdorur nga deputeti Saimir Tahiri gjatë udhëtimeve në Greqi. Në këto udhëtime rezultojnë që personi në hetim Saimir Tahiri ka qënë i shoqëruar nga subjekte të tjera të dyshuara Artan Habilaj etj.

2.5.1. Prokuroria pranë Gjykatës së shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, nisur nga sa ka parashtruar në relacionin shoqërues drejtuar Kuvendit për dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë, kontrollit personal dhe të banesës të deputetit Saimir Tahiri, arsyeton se në kushtet e sekuestrimit të lëndës narkotike, dhënies së shpërblimeve nga grupi kriminal funksionarve të lartë zyrtarë, mbajtja e kontakteve të vazhdueshme të tyre me ish Ministrin e Brendshëm z. Saimir Tahiri, ekziston dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprimtarisë kriminale dhe përfshirjen në këtë veprimtari të të dyshuarit z. Saimir Tahiri.

Për këtë arsye Prokuroria pranë Gjykatës së shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, konstaton se gjendet para elementëve të figurës të veprave penale të:

1- *“Trafikimi i narkotikëve” kryer në bashkëpunim, në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a2 dhe 333/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.*

2. *“Korrupsion pasiv i funksionalëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë” parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal .*

2.5.2. Në këto kushte në relacionin që shoqëron kërkesën, Prokuroria pranë Gjykatës së shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, parashtron se në kuadër të ushtrimit të ndjekjes penale, për t'i hapur rrugë një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, bazuar në nenet 72/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 288 të Kodit të Procedurës Penale, i kërkon Kuvendit dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë, kontrollin personal dhe të banesës të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë shtetasit Saimir Tahiri.

2.6. Të njëjtave parashtrime të paraqitura në kërkesë dhe në relacionin shoqërues, prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, Besim Hajdarmataj, Elisabeta Imeraj, Gentian Osmani, prezantuan edhe para Këshillit. Prokurorët deklaruan se duke iu referuar të gjitha këtyre të dhënave, duke pasur parasysh se në asnjë moment, që nga viti 2013 dhe deri në muajin prill të vitit 2017, kur z. Saimir Tahiri ishte Ministër i Brendshëm, asnjëherë nga Policia e Shtetit nuk është referuar një material në Prokurorinë për Krimet e Rënda ose në një prokurori tjetër, për aktivitetin kriminal të këtyre personave. Ndërkohë, prokuroria italiane po zhvillonte hetime për këtë grup personash, ku rezultonte se ishte kapur edhe një sasi e konsiderueshme e lëndëve narkotike. Duke pasur parasysh edhe lidhjet që këta persona kanë me punonjës të Drejtorisë së Policisë Vlorë, për të cilët prokurorët deklaruan se kanë fakte, kanë krijuar bindjen e plotë se janë para një rasti kur deputeti Saimir Tahiri, është i përfshirë në këto lloj aktiviteti kriminal.

2.7. Prokurorët i parashtruan Këshillit se relacionin e kishin shoqëruar me prova sipas kërkesës së nenit 288 të Kodit të Procedurës Penale dhe në lidhje me shqyrtimin e dokumentacionit, i sugjeruan Këshillit se për shkak të ruajtjes së sekretit dhe natyrës konfidenciale të këtyre

dokumentave të cilat nuk duhet të bëhen publike, shqyrtimi i tyre të relizohet pa praninë e medias.

2.8. Pas parashtrimit të kërkesës së prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rrënda Tiranë, deputetët i drejtuan pyetje prokurorëve për t'u sqaruar rreth objektit të kërkesës dhe çështjeve të parashtruara nga ana e tyre .

Pyetjet e shtruara nga deputetët, u fokusuan për të sqaruar: i) kohën kur Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimeve të Rrënda Tiranë, ka regjistruar procedimim penal dhe regjistruar si person në hetim deputetin Saimir Tahiri; ii) të dhënat, faktet ku organi i prokurorisë është bazuar; iii) nëse prokurorët kishin të dhëna apo dyshim të arsyeshëm që z.Saimir Tahiri do t'i shmangej hetimit apo do të prishen provat e hetimit sipas kërkesave të parashikuara në nenet 228, 229 të Kodit të Procedurës penale; iv) mënyrën se si kishte vepruar Prokuroria për administrimin e materialeve të ardhura në funksion të këtij procedimi në ngarkim të shtetasit dhe deputetit Saimir Tahiri; v) nëse kërkesa për dhenien e autorizimit për arrestin ose kufizimin e lirisë është në përputhje me kushtet e parashikuara nga KEDNJ dhe në Kodin e Procedurës Penale ; v) se në harkun kohor prej 48 orësh, nga shkrimi në gazete dhe në portale të një materiali 416 faqësh ka qënë e mjaftueshme që konform nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, të kërkohet arrestimi i deputetit Saimir Tahiri etj.

2.9. Gjatë debatit për shqyrtimin e kërkesës së Prokurorëve pyetje prokurorëve u drejtoi dhe deputeti z. Saimir Tahiri, i cili u kërkoi që të sqaronin faktin se nga ana e tij, (ndryshe nga sa parashtruan prokurorët, se nuk ka patur asnjë referim nga Policia e Shtetit në kohën që ka ushtruar detyrën e Ministrit të Brendëshëm), në vitin 2015 është depozituar kallëzim në Prokurorinë e Krimeve të Rrënda në vijim të disa deklaratave të bëra publike për përfshirjen e makinës së tij në trafik droge. Prokuroria e Krimeve të Rrënda ka regjistruar procedimin penal nr. 1582 në vitin 2015. Çështja u hetua nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, e cila në përfundim të hetimve paraprake ka vendosur pushimin e çështjes. Gjithashtu në pyetjet e tij kërkoi sqarime rreth relacionit të Prokurorisë.

3. Mbledhja e Këshillit në datën 21.10.2017, vazhdoi me parashtrimet e avokatit të deputetit Saimir Tahiri. Në parashtrimet e tij para Këshillit, avokati analizoi kërkesën dhe relacionin shoqërues të organit të prokurorisë në disa aspekte:

3.1. Në lidhje me rrethanat e faktit të parashtruara në kërkesë

Në lidhje me rrethanat e faktit, avokati i deputetit Tahiri e konsideron kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë, si të pa argumentuar, e pa mbështetur në prova dhe për më tepër e motivuar politikisht.

3.1.1. Sipas avokatit kërkesa nga pikëpamja e përmbajtjes ka vetëm dy dokumenta që prokuroria i kualifikon si prova, konkretisht kqyerja e sistemit TIMS dhe kontrata e shitjes së automjetit e datës 05. 11. 2013, ish pronë e deputetit Saimir Tahiri në favor të shtetasit Artan Habilaj. Në të dyja këto fakte organi i prokurorisë nuk arriti të provojë se cilët ishin personat e tjerë që deputeti paska udhëtuar sipas tyre në këto data, si dhe nuk solli asnjë të dhënë rreth dyshimeve të aktivitetit kriminal të Artan Habilaj.

3.1.2. Avokati në parashtrimet e tij argumenton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë, nuk ka paraqitur para këtij këshilli një provë të administruar në procedimin penal në kuptim të ligjit procedural, si dokumentin e arrestimit të shtetasit Moisi Habilaj në shtetin Italian. Gjithashtu prokurorët nuk sqaruan akuzat me të cilën është regjistruar procedimi penal në shtetin Italian si dhe akuzat për të cilat, organi i prokurorisë ka regjistruar procedimet penale 134/2016 dhe 164 /2017, që të tregonin përfshirjen në bashkëpunimin midis personave nën akuzë në shtetin Italian dhe personave të tjerë me funksione zyrtare apo shtetërore përfshi këtu edhe deputetin Saimir Tahiri, për të cilat kërkohet masa e sigurimit të arrestit në burg ose çdo formë tjetër e heqjes së lirisë.

3.1.3. Duke ju referuar ndryshimeve kushtetuese, avokati argumentoi se nuk ka asnjë pengesë për hetime apo marrje si të pandehur të deputetit Saimir Tahiri, i cili për sa i përket veprimeve hetimore nuk është bërë pengesë, ka qënë dhe është i gatshëm që të paraqitet në çdo kohë pranë organit të Prokurorisë për të dhënë sqarimet e nevojshme dhe për t'i shkuar deri në fund të vërtetës.

3.1.4. Lidhur me sa pretendon në kërkesën e tij organi i prokurorisë se bashkëpunëtorë të shtetasit në hetim Moisi Habilaj janë dhe zyrtarë të lartë të policisë së shtetit në bashkëpunim edhe me deputetin Tahiri, (në kohën që ka qënë Ministër), prokurorët nuk mundën të shpjegojnë se kush janë këta persona apo të japin rrethana të tjera apo detaje rreth këtij grupi të strukturuar, kriter ky për të patur një dyshim të arsyeshëm për ezksitencën e veprës penale të grupit të strukturuar kriminal (neni 333/a K. Penal). Gjithashtu nuk argumentuan lidhjen shkaksore midis veprimtarisë së personit të arrestuar dhe në hetim me pozicionin e ish ministrit të deputetit z. Saimir Tahiri.

3.1.5. Edhe nga përgjimet telefonike, Prokuroria në relacion nuk solli asnjë fakt apo indicje që nga këto përgjime të subjekteve të dyshuara, deputeti Saimir Tahiri të kishte komunikuar qoftë dhe njëherë të vetme në çfaredo lloj forme me këta persona të dyshuar.

3.1.6. Nga aktet që ka nxjerë media shqiptare kuptohet që organet e procedimit në Itali kanë hetuar për një kohe prej rreth katër vjetësh dhe vetëm disa ditë më parë kanë arrestuar personat e dyshuar. Ndërsa duket shume disproporcional fakti që arresti për deputetin Saimir Tahiri kërkohet si veprimi i parë në funksion të hetimeve, pa kryer asnjë hetim tjetër për të cilat është e lirë ti kryejë në fshehtësi dhe pa marrë autorizim nga Kuvendi, (ndryshimet e reja kushtetuese).

Në mbledhjen e Këshillit, avokati paraqiti si prove dhe depozitoi, vendimin e pushimit të çështjes penale nr. 1582/2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier në lidhje me hetimin e kërkuar nga z. Saimir Tahiri, për sa i përket përfshirjes së automjetit tip Audi A8, me targa AA 003 GB, në aktivitetin kriminal të trafikimit të lëndëve narkotike. Prokuroria e shkallës së Parë Fier parashtoi avokati ka arritur në konkluzionin se nga të gjitha aktet e administruara “*ky fakt nuk ekziston*”.

3.2. Raporti kushtetues i Kuvendit me organin e Prokurorisë dhe natyra e procesit të rregullt ligjor.

3.2.1. Avokati i deputetit Z. Saimir Tahiri në parashtrimet e tij për raportin Kushtetues të Kuvendit me organin e Prokurorisë dhe natyrën e procesit të rregullt ligjor solli në vëmendje të Këshillit, standartet e krijuara nga jurisprudenca kushtetuese, ajo e GJEDNJ dhe praktika unifikuese e Gjykatës së Lartë në rastin e shqyrtimit të kërkesave me natyrë të tillë juridike.

3.2.2. Duke iu referuar nenit 27/2 germa “c” te Kushtetutes, rregullave të hollesishme të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale për rastin e parashikuar nga neni 5, pika 1, germa “c” e GJEDNJ, e konsideron kërkesën e paraqitur nga organi i Prokurorisë në kundërshtim me përmbajtjen e këtyre dispozitave. Prokuroria sipas avokatit, as në kërkesë dhe as në relacion nuk parashtroi asnjë fakt se ndodhemi në kushtet e aplikimit të nenit 228, 229 të Kodit të Procedurës Penale për t’i kërkuar Këshillit të Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit, dhënien e autorimit për arrestimin apo heqjen e lirisë së deputetit Saimir Tahiri.

3.3. Në lidhje me standartin e Jurisprudencës Kushtetuese dhe atë të GJEDNJ

3.3.1. Ndryshimet Kushtuese kanë tejkaluar konceptin e debatuar të imunitetit të deputetit dhe parlamenti shqiptar bën pjesë në atë sistem kushtetues të atyre kushtetutave që nuk parashikojnë më çështjen e imunitetit si ndalesë për organin e hetimit, por organi i prokurorisë tashmë mund ta hetojë lirisht një deputet ashtu si çdo shtetas tjetër, për më tepër ta marrë edhe si të pandehur.

3.3.2. Në këto kushte parashtroi avokati, deputeti Saimir Tahiri nuk ka asnjë ndalesë kushtetuese që të hetohet nga organi prokurorisë. Kushtetuta ja ka dhënë të drejtën organit të prokurorisë që të hetojë deputetin për çdo lloj vepre penale, por në rastin konkret sipas avokatit organi i Prokurorisë nuk e ka bërë këtë, por po abuzon politikisht me kërkesën e saj.

3.3.3. Në parashtrime, avokati iu referua disa raporteve të Komisionit te Venecias të hartuara ndër vite, për t’ia sjellë në vëmendje Këshillit, në lidhje me drejtimet kryesore të qellimit dhe procedurave për heqjen e imunitetit parlamentar.

3.3. 4. Raportin CDL-AD(2014)011 parashikon jo vetem kriteret që duhet të plotësohen nga organi procedures për të kërkuar heqjen e imunitetit, por tregon dhe si duhet të jenë procedurat për shqyrtimin e këtyre kërkesave.

3.3.5. Në këto kushte, avokati i kërkoi Këshillit që të injorojë qëndrimin e prokurorisë që i kërkon të vlerësojë çështjet e lidhura me aplikimin e masave të sigurimit personal ashtu sic jane të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale, pasi procedurat parlamentare nuk duhet t’i përngjajnë atyre gjyqësore.

III. VLERËSIMI I KËSHILLIT PËR RREGULLOREN, MANDATET DHE IMUNITETIN

Këshilli vazhdoi shqyrtimin me dyer të mbyllura, ku deputetet anëtarë të këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin u njohën me provat e sjella nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë, për të cilat prokurorët që në fillim të mbledhjes parashtruan se përbënin sekret hetimor.

Ne deputetet e mazhorancës në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, çojmë të mbajmë parasysh në shqyrtimin e kërkesës në fjalë, ndryshimet që iu bënë Kushtetutës nëpërmjet ligjit nr.88/2012 në lidhje me imunitetin e kufizuar të deputetit, si një premisë për fuqizimin e shtetit ligjor dhe luftën pa kompromis ndaj fenomeneve kriminale, pavarësisht rangut të zyrtarëve që dyshohet se kryejnë veprat penale.

Ndryshe nga sa parashikohej deri më atëherë nga Kushtetuta e vitit 1998, me konsensusin e të gjitha partive politike, Kuvendi i Shqipërisë hodhi një hap të matur dhe të rëndësishëm përpara në garantimin e funksionalitetit të plotë të shtetit ligjor në vendin tonë. Deri në vitin 2012, organi procedues nuk mund të niste dhe nuk mund të kryente asnjë veprim procedural ndaj deputetit që gëzonte imunitet kushtetues, nëse ai/ajo ishte i/e dyshuar për kryerjen e një vepre penale. Me ndryshimet ligjore të sipërpërmendura, ky imunitet u kufizua vetëm në rastet kur kërkohej arrestimi, heqja e lirisë (ndalimi), kontrolli personal dhe kontrolli i banesës.

Ky është një proces, që siç edhe vërtetohet nga kërkesa konkrete, (Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka rregjistruar tashmë një procedim penal në ngarkim të personit në hetim z.Saimir Tahiri), i jep mundësinë organit procedues që në ushtrim të funksionit kushtetues për ndjekjen penale, të mund të iniciojë, zhvillojë hetime, të kryejë çdo veprim procedural që çmon të nevojshëm në përmbushje të objektivit primar, garantimin dhe dhënien e drejtësisë në një shtet, ku ligji është i barabartë për të gjithë shtetasit.

Në opinionin e Komisionit të Venecias CDL-AD (2006)005 (*mars 2006*) në lidhje me procedurat për kufizimin e imunitetit parlamentar dhe kushtet për dhënien e autorizimit për ndjekjen penale parashtrohet se: *“E drejta e Parlamenteve për të hequr imunitetin e anëtarëve të tyre është pjesë e padiskutueshme e traditës parlamentare evropiane. Objektivi kryesor i dispozitave që*

garantojnë imunitetin parlamentar është mbrojtja e vetë Parlamentit dhe në mënyrë të vecantë e funksionimit të duhur të tij. Imuniteti parlamentar nuk është një privilegj personal i secilit prej anëtarëve të Parlamentit”.

Deputetët e mazhorancës në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin vlerësojnë se, është pikërisht kjo fryma dhe standarti më i lartë që do të duhet të mbahet parasysh dhe të vlerësohet sa herë që bazuar në dispozitat përkatëse të Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit, organi që me Kushtetutë ka tagrin e ushtrimit të ndjekjes penale, pra prokuroria, t’i drejtohet parlamentit për të kërkuar autorizimin që prek ato elementë që përfshihen në imunitetin e deputetit.

Në raportin CDL-AD (2014)011 (maj 2014), për fushën e veprimit dhe heqjen e imunitetit parlamentar të hartuar bazuar në kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm të KiE, Komisioni i Venecias argumenton se: *“Komisioni i Venecias vlerëson për më tepër që organi parlamentar që shqyrton kërkesën për heqjen e imunitetit nuk duhet të bëjë një vlerësim ligjor të çështjes si e tillë. Në veçanti, ky organ nuk duhet në asnjë rrethanë të japë qëndrimin e tij për fajësinë ose jo të deputetit përkatës apo të bazueshmërinë së procedimit penal.”*

Nisur nga ky qëndrim i Komisionit të Venecias, deputetët e mazhorancës në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, cmojnë se në rastin konkret, Këshilli nuk mund të marrë në shqyrtim vlerën e provave dhe fakteve që shoqërojnë kërkesën e paraqitur nga ana e organit procedues. Kjo pasi, Kuvendi i Shqipërisë do të cënonte një tjetër parim të rëndësishëm të shtetit ligjor, sic është ai i ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Kuvendi në këto raste, duhet të shqyrtojë nëse plotësohen kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 73/2 të Kushtetutës, nenin 288, prg. 1 dhe 2, nenit 228 të K.Pr.Penale, sic do të arsyetohet më poshtë në këtë raport.

Vlerësimin në rast se janë ose jo kushtet dhe kriteret për vendosjen e një mase sigurimi personal apo për kryerjen e veprimeve të tjera procedurale, e bën sistemi gjyqësor nëpërmjet organit të tij, gjykatës, bazuar në parashikimet e posacme të Kodit të Procedurës Penale, neni 244 e vijues i Kodit të Procedurës Penale. Është vetëm gjykata, organi i vetëm kushtetues, që mund të marrë në

shqyrtim, të cmojë dhe në fund të disponojë në lidhje me kërkesat e organit të prokurorisë gjatë hetimeve paraprake, në rast se ato i gjen eventualisht të mbështetura në prova dhe në ligj.

Në të njëjtin raport të Komisionit të Venecias, të cituar më lart, është trajtuar dhe kujdesi që duhet treguar në trajtimin e kërkesave të tilla për dhënie autorizimi, referuar interferencave të mundshme politike. Në këtë raport është argumentuar qartë se: *“Komisioni i Venecias në përgjithësi vlerëson se duhet të ekzistojë një prezumim themelor që imuniteti duhet të hiqet në të gjitha rastet, kur nuk ka asnjë arsye për të dyshuar se akuzat ndaj deputetit përkatës janë të motivuara politikisht.”*

Nisur nga këto elementë që janë trajtuar në këtë dokument të Komisionit të Venecias, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetit pasi u njohën:

- me kërkesën dhe relacionin shoqërues të prokurorisë pranë Gjykatës së shkallës së Parë për Krime të Rënda, për dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë, kontrollin personal dhe të banesës të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë z. Saimir Tahiri;
- me materialet shkresore të sjella në mbështetje të kërkesës;
- dëgjuan parashtrimet e prokurorëve, avokatit dhe të vetë deputetit z. Saimir Tahiri;

paraqitën mendime të ndryshme mbi kriteret Kushtetuese dhe proceduriale të vlerësimit të kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë, kontrollin personal dhe të banesës të deputetit Saimir Tahiri.

Deputetët e opozitës në diskutimet e tyre u shprehën pro dhënies së autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë, kontrollin personal dhe të banesës të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë Saimir Tahiri, duke e konsideruar atë si një standart moral dhe politik. Deputetët e opozitës e konsiderojnë se dhënia e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë, kontrollin personal dhe të banesës të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë z. Saimir Tahiri, krijon mundësinë që deputetët të çohen para drejtësisë. Këshilli vlerësoi ata, nuk jep masa sigurimi dhe nuk vlerëson dot prova. Detyra e deputetëve sipas tyre është të verifikojë nga pikëpamja formale nëse kërkesa është bërë nga organi i parashikuar në Kushtetutë, nëse kërkesa plotëson kushtet e parashikuara

në Kodin e Procedurës Penale. Për deputetët e opozitës kërkesa e Prokurorisë është në përputhje me parashikimet në Kushtetutë, Kodin e Procedurës Penale dhe Rregulloren e Kuvendit për rastin objekt shqyrtimi.

Ndryshe nga sa arsyetojnë deputetët e opozitës, në deputetët e mazhorancës në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetit në vlerësimin e kërkesës së Prokurorisë i referohemi kushteve të parashikuara në kuadrin Kushtetues dhe ligjor të cilat parashikojnë premisat dhe procedurën e shqyrtimit të saj.

Neni 118 i Rregullores së Kuvendit, i kërkon këtij Këshilli të shprehet për kriteret formale dhe proceduriale të kërkesës së ardhur nga organi i akuzës. Nga pikëpamja formale, kërkesa e organit të akuzës bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 73, pika 2. Prokuroria pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda legjitimohet për t'i paraqitur këtë kërkesë Këshillit të Mandateve dhe Imunitetit të Kuvendit të Shqipërisë.

Objekti i kësaj kërkesë është: *“Dhënia e autorizimit për arrestimin, heqjen e lirisë (ndalimin), kontrollin personal dhe kontrollin i banesave të deputetit Saimir Tahiri”*.

Për qartësi dhe për evituar konfondimet që bëhen në opinion publik se jemi përpara rastit të heqjes së imunitetit të deputetit, duke nënkuptuar fillimin e ndjekjes penale, në deputetët e mazhorancës cmojmë të theksojmë se ndjekja penale ndaj deputetit Saimir Tahiri, ka filluar, pasi këtë të drejtë, sic është sqaruar më sipër në këtë raport, organit të akuzës ia ka dhënë Kushtetuta dhe ligji.

Ajo që i kërkohet Kuvendit është arrestimi, heqja e lirisë (ndalimi), kontrolli personal dhe kontrolli i banesave të deputetit Saimir Tahiri. Janë pikërisht këto kërkime që duhen shqyrtuar e u duhet dhënë përgjigje nga Kuvendi me vendim sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

Nisur nga sa më sipër, çështjet që shtrohen për shqyrtim nga ana e Këshillit janë:

- i) nëse kërkesa për autorizim plotëson kushtet ligjore të parashikuara në Kushtetutë dhe në Kodin e Procedurës Penale;

- ii) nëse kjo kërkesë e organit të akuzës shoqërohet me një relacion të arsyetuar;
- iii) nëse relacioni shoqërohet me prova që mbështesin kërkesën;
- iv) nëse kjo kërkesë është bërë apo jo nën ndikimin politik.

Për të sqaruar çështjet e mësipërme referim bëhet në nenin 288, prg. 1 dhe 2, si dhe nenit 228 të K.Pr.Penale.

Nga analiza e dispozitave të mësipërme, rezulton se:

- i) Kuvendi ka kompetencën që të vlerësojë nëse plotësohen kushtet ligjore për të dhënë autorizimin për marrjen e një mase të sigurimit personal sic është arresti në burg apo në shtëpi, heqja e lirisë në cfarëdolloj forme, kontrolli personal dhe i banesës së deputetit Saimir Tahiri;
- ii) Nëse plotësohen apo jo këto kushte, Kuvendi duhet të bazohet në gjykimin e vet, duke iu referuar relacionit të organit të akuzës dhe provave që mbështesin këtë relacion;
- iii) Kuvendi nuk duhet të bëjë vlerësim të provave, por vlerësim të kushteve dhe rrethanave që të krijojë bindjen e vet se ekzistojnë dyshime të arsyeshme dhe të bazuara se deputeti ka kryer një vepër penale, do të kryejë një vepër penale, do të prishë provat e një hetimi të nisur, apo ekziston rreziku se deputeti do t'i shmanget drejtësisë duke u larguar;
- iv) Nëse kërkesa është bërë nën ndikime politike apo jo.

Fillimisht, cmojmë të nënvizojmë se në shqyrtime të këtij lloji, interesi mbizotërues është drejtësia dhe dhënia e të gjitha mundësive organit procedues për të hetuar e për të zbuluar deri në fund të vërtetën, por në këto raste detyrë e Kuvendit është të respektojë disa standarde kushtetuese për garantimin e procesit të rregullt ligjor dhe të drejtave themelore të njeriut. Kjo për arsye se jemi përpara rastit të një kërkesë për një masë ekstreme, arresti ose kufizimi i lirisë, një e drejtë themelore e njeriut, siç është liria e personit, e mbrojtur edhe nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, (neni 5) dhe nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e drejte kjo e cila nuk mund të kufizohet, përveç se në rastet kur:

1. Ka dyshime të arsyeshme dhe të bazuara se personi ka kryer një vepër penale;

2. Duhet të parandalohet një vepër penale që personi mund ta kryejë nëse nuk i kufizohet liria;
3. Ekziston rreziku se personi do të largohet.

Këshillit, në rastin e kësaj kërkesë i kërkohet të vlerësojë edhe faktin nëse kërkesa e organit të akuzës bazohet në kërkesat standarde që ka Kodi i Procedurës Penale në lidhje me një proces penal të rregullt, apo kërkesa e organit të akuzës është e motivuar apo ka sfond politik, apo është e motivuar nga shkaqe të tjera që nuk kanë lidhje me procesin e rregullt penal.

Për sa më sipër, Këshilli i referohet edhe Raportit CDL-AD(2014)011, ku jepen disa kritere që në fakt lidhen qartazi jo me mundësinë për të lejuar arrestin ndaj një deputeti, por me nevojën për të lejuar procedimin penal me qëllimin që drejtësia të mund të veprojë ndaj të gjithë shtetasve njëjloj. Në këtë raport, ndër të tjera theksohet se duhet vlerësuar nëse:

- kërkesa për të hequr imunitetin është mbështetur në argumenta serioze, të sinqerta dhe të ndershme;
- anëtari në fjalë (deputeti) është kapur në flagrancë;
- shkelja e pretenduar është e një natyre shumë serioze;
- kërkesa lidhet me një sjellje kriminale që nuk ka të bëjë me aktivitetin parlamentar, por lidhet me akte të kryera në lidhje me të tjera funksione personale ose profesionale;
- procedimi duhet lejuar me qëllim për të mos penguar drejtësinë;
- procedimi duhet lejuar me qëllim që të ruajë autoritetin dhe legjitimitetin e parlamentit;
- anetari kërkon vetë që imuniteti të hiqet;

Këto procedura duhet të jenë të rregulluara qartë dhe duhet të përputhen me parimet e pergjithshme të ligjit procedural, përfshirë të drejtën e të dyja paleëve për t'u dëgjuar. Ato duhet të jenë të kuptueshme, të qarta dhe të parashikueshme dhe procedura duhet të jetë e hapur për publikun. Procedurat duhet të respektojnë në çdo rast parimin e prezumimit të pafajësisë, ashtu sic është e mbrojtur nga KEDNJ.

Për të mos rënë në përsëritje me sa është thënë më sipër, kriterin e procedimit për të mos penguar drejtësinë e përmban vetë Kushtetuta e Republikës që lejon hetimin ndaj deputetit pa nevojën e autorizimit nga Kuvendi.

Në analizë të sa më sipër dhe nga shqyrtimi i kërkesës së organit të akuzës, relacionit përkatës dhe provave të paraqitura, shpjegimeve të dhëna gjatë mbledhjeve që realizoi Këshilli, rezultoi qartësisht se nuk ekzistojnë dyshime të arsyeshme dhe të bazuara për të përligjur dhënien e autorizimit për masën e arrestit ndaj deputetit Saimir Tahiri.

Në materialin prej më pak se 5 faqe, por edhe gjatë sqarimeve të dhëna në mbledhjet e Këshillit, organi i akuzës nuk mundi të argumentojë përfshirjen e deputetit Tahiri në veprimtari kundërligjshmërie dhe nuk paraqiti asnjë indicje, fillim prove apo provë që të krijonte bindjen tonë se ka dyshime të arsyeshme dhe të bazuara për të autorizuar vijimin e procedurave për masën ekstreme të arrestit ndaj deputetit Tahir.

Veprat për të cilat është regjistruar procedimi penal në ngarkim të Z. Tahiri janë nga më të rëndat që përmban Kodi Penal, edhe pse Prokuroria nuk ka bërë asnjë ditë hetim ndaj z. Tahiri, por i është referuar materialeve të procedimit penal të kryer nga organet e shtetit italian dhe disa akteve të tjera të marra nga organi i akuzës në R.Shqipërisë në kuadër të procedimit/procedimeve penale të mëparshme.

Nga shqyrtimi i këtyre materialeve, që u paraqitën si prova nga organi i akuzës rezulton se emri i deputetit Tahiri, përmendet nga persona të tretë që hetohen për vepra penale në fushën e narkotrafikut nga organet e drejtësisë së shtetit italian, por në asnjë material të paraqitur, si në materialet e vëna e ardhura nga organet e drejtësisë italiane, ashtu dhe në materialet e procedimeve penale të nisura nga organi i akuzës në R.Shqipërisë nuk rezulton në asnjë moment që deputeti Tahiri të ketë qënë pjesë e komunikimeve, veprimeve apo situatave të tilla që do të krijonin bindje se është përfshirë në veprimtari kriminale.

Është gjithashtu detyrë e rëndësishme e Kuvendit, për të gjykuar nëse kërkesa mund të ketë apo jo sfond politik për shkak të ushtrimit të funksioneve kushtetuese që ka deputeti. Kjo nuk mund

të bëhet apriori, por duke u nisur nga provat që shoqërojnë kërkesën. Në këtë rast pa analizuar përmbajtjen e vetë provës, Këshilli duhet të analizojë nëse dokumentat që shoqërojnë relacionin e organit të akuzës në kuptimin procedural, janë prova apo mjete të kërkimit të provës, sipas përcaktimeve të Kodi i Procedurës Penale.

Dokumentat që mbështesnin relacionin e organit të akuzës, të paraqitura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë, nuk përbëjnë provë në kuptimin e provave që kërkon neni 149 dhe neni 198 i Kodit të Procedurës Penale në Republikën e Shqipërisë. Materiali i përgjimit i bërë ndërmjet dy apo pesë banditëve, për të cilët prokuroria italiane ka kryer hetime mbi 3-vjeçare dhe tashmë dosja është në gjykatën përkatëse, nuk përbën provë në kuptimin e provave sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale.

Përgjimet janë mjete për të kërkuar provën. Por, duke pasur parasysh se Kuvendi nuk është gjykatë dhe në këto rrethana nuk vlerëson provën, nëse nga materialet e paraqitura do të kishte një element të vetëm, për përfshirje të Z. Tahir në veprimtari kriminale, kjo padiskutim do të merrej parasysh. Në fakt nuk rezultoi kjo përfshirje në asnjë nga materialet që u morën në shqyrtim. Për efekt të respektimit të angazhimit tonë, për të mos nxjerrë të ashtuquajturat sekretet hetimore, që për ne nuk ishin aspak të tilla dhe i duheshin bërë me dije dhe opinionit publik, nuk po citojmë konkretisht asnjë prej tyre.

Në këto kushte kërkesa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë deputetit Saimir Tahiri nuk plotëson aspektin procedural, pikërisht kërkesat e nenit 288, pika 2 të Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk u shoqërua me prova që të përligjinin dyshimin e arsyeshëm e të bazuar për krijimin e mundësisë së dhënies së një mase ekstreme që kufizon lirinë e personit.

Mungesa e provave, nxitimi i organit të akuzës për të kërkuar dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë së deputetit Saimir Tahiri, dy ditë pasi ka rregjistruar procedimin penal dhe emrin e tij në rregjistrin e çështjeve penale, krijon bindjen se në këtë stad të hetimeve që ka kryer Prokuroria kërkesa ka sfond politik.

Kuvendi ka detyrimin të respektojë standardin kushtetues të të drejtave të njeriut, si të drejta themelore të pakundërshtueshme, jo vetëm për deputetin, por për të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë, ku e drejta e lirisë është një e drejtë, e cila nuk mund të cenohet me fjalë, me llafë apo dyshime të pabazuara në dokumente, në prova, në fakte, të cilat i krijojnë bindjen gjithsecilit se ka një të vërtetë, që nuk mundet ta shkelim.

Ndoshta sot, për kredo politike, shumë mund ta fitojnë një betejë, por nuk do të na e falë as historia e së drejtës së këtij vendi, as vetja jonë në të ardhmen dhe as ndërgjegjja jonë në qoftë se nuk jemi të bindur, dhe marrim një vendim, i cili cenon atë që quhet Kushtetutë. Ky këshill dhe ky Kuvend, është për të vendosur respektimin e një standardi kushtetues dhe procedural, karshi një mase ekstreme që është arrestimi i një deputeti.

Të vërtetën e presim nga drejtësia, nga këto institucione të drejtësisë që kemi. Por, ama, jo t'i hapim rrugë në harkun kohor të 48 orëve, pa kryer asnjë veprim procedural nga ato që kërkon Kodi i Procedurës Penale, arrestimit të një deputeti, qoftë ky edhe një qytetar i zakonshëm i Republikës së Shqipërisë. Ky është ndryshimi mes sistemit që iku dhe sistemin që po përpiqemi të ndërtojmë këto 27 vjet, respektimi i garancive kushtetuese dhe procedurale për një proces të rregullt ligjor.

Autorizimi që na kërkohet për arrestin dhe heqjen e lirisë së deputetit Saimir Tahiri, çmohet nga ne si një masë e panevojshme dhe e papërshtatshme, duke iu referuar akteve që morën në shqyrtim e analizuam me shumë kujdes e përgjegjshmëri.

Në kushtet kur organi i akuzës e ka nisur procedimin penal ndaj deputetit Saimir Tahiri, ky hetim duhet të vazhdojë e i duhen krijuar të gjitha kushtet që kjo situatë të zbardhet sa më shpejt, në interes të drejtësisë dhe të publikut.

KONKLUZIONE

Në të tilla kushte, mbështetur në parimet tona kushtetuese për funksionimin e shtetit të së drejtës, barazisë së të gjithë shtetasve përpara ligjit, opinioneve të Komisionit të Venecias, rrethanave të parashtruara nga prokuroria dhe vlerësimit të ekzistencës së motivimit politik në paraqitjen e kësaj kërkesë nga ana e prokurorisë, mos respektimit nga ana e Prokurorisë të kërkesave të nenit 288 të Kodit të Procedurës Penale, ne deputetet e mazhorancës të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, i rekomandojmë Kuvendit të votojë:

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për:
 - Dhënien e autorizimit për kontrollin personal dhe të banesës për deputetin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Saimir Tahiri.
 - Dhënien e autorizimit për ndalimin e daljes jashtë shtetit, detyrimin për t'u paraqitur në policinë gjyqësore, ndalimin dhe detyrimin për qëndrimin në një vend të caktuar, si masa shtrënguese të heqjes së lirisë në kuptim të gërmave a), b), c) të nenit 232 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.
2. Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për dhënien e autorizimit për masën e arrestit në burg ose në shtëpi për deputetin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Saimir Tahiri, në kuptim të shkronjave d) dhe dh) të nenit 232 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

Deputetët

Vasilika HYSI




Ulsi MANJA



Klotilda BUSHKA (FERHATI)



Bledar ÇUÇI



KRYETAR

Gramoz RUÇI

